

02.06.2023
Nr.P. 08/253

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL DHE ORGANIZATA “QATAR CHARITY”

NJOFTIM

Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Organizata “Qatar Charity” në kuadër të marrëveshjes së arriturë me nr. Prot. 01/773 të datës 31.05.2023 në komunën e Malishevës, do të implementoj projekte në sektorin e bujqësisë blegtorisë dhe zhvillimit rural për fermerët e Komunës së Malishevës, këto projekte janë si më poshtë:

- Serrë bujqësore për kultivim me sipërfaqe 96m² dhe sistem të ujitjes;
- Shoqëri bletësh me 8-tetë bletë;
- Frezë dheu për traktor;
- Kositëse bari për traktor;
- Moto-kultivator me frezë dhe kosë;

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriterët si:

- ✓ Të jetë banorë i Komunës së Malishevës;
- ✓ Të ketë mundësi për ta realizuar projektin;
- ✓ Të ketë përshtatshmëri të vendit për realizimin e projektit;
- ✓ Përparësi kanë familjet të cilët nuk kanë përfituar më parë ;
- ✓ Përparësi kanë familjet që jetojnë në kushtet të rënda ekonomike;
- ✓ Përparësi kanë familjet që jetojnë në zonat e thella rurale.

Në kushte të barabarta përparësi do të kenë:

- Familjet me numër më të madh të antarëve;
- Familjet me asistencë sociale;
- Familjet me fëmijë jetim;
- Familjet me anëtarë që vuajnë nga sëmundje të rënda kronike apo ivaliditet;
- Fermerët të cilët jetojnë në zona të thella rurale të Komunës së Malishevës;

Dokumentet obligative për aplikim:

- Kërkesën e plotësuar për aplikim;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën nga Gjykata Themelore në Malishevë, që dëshmon se aplikuesi nuk është nën hetime;
- Çertifikatën e Bashkësisë Familjare;
- Konfirmimin e të ardhurave (pasqyra bankare për periudhën kohore 6 muaj të fundit dhe/ose dokument zyrtar nga ana e institucioneve të vendit i cili vërteton se personi në fjalë është i pa-punë);
- Vërtetimin e tatimit në pronë.

Dokumentet shtesë për aplikim:

- Dokumente zyrtare kopje (*familjet me anëtarë që kanë sëmundje të rënda kronike apo ato me invaliditet*);
- Kartelën e ndihmës sociale kopje (*familjet me asistencë sociale*);

Marrja e aplikacioneve si dhe dorzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën pritëse në Komunën e Malishevës, prej datës **02.06. 2023** deri me datën **16.06.2023** nga ora 09:00-15:00h.

Vëmendje: Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në një kopje dhe brenda periudhës së aplikimit, pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

Drejtori i DBPZHR-së Malishevë
Syle Dukolli ecc. i dip.

